



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA MALISHEVË
ZYRTARJA PËR BARAZI GJINORE



Datë: 29.01.2025

Nr: 01/74

***Raport pune – ZBGJ
Janar –Dhjetor 2024***

Promovimi i barazisë gjinore është një prioritet thelbësor, duke reflektuar angazhimin tonë për një mjedis pune gjithëpërfshirëse dhe të drejtë.

Ky raport vjetor përmbledh përpjekjet, arritjet dhe sfidat që kemi adresuar përgjatë vitit për të siguruar që i gjithë komuniteti, pavarësisht nga gjinia, të kenë mundësi të barabarta për zhvillim profesional dhe personal.

Ky raport synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe transparente mbi të arriturat dhe mbi fushat ku ende mbetet punë për t'u bërë. Ai shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme, duke fuqizuar zyrën tonë si një vend pune me të drejta të barabarta.

Qëllimi ynë është të kontribuojmë në krijimin e një mjedisi ku gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë të kenë mundësi të barabarta për të realizuar potencialin e tyre të plotë.

Ky raport është jo vetëm një përmbledhje e përpjekjeve dhe arritjeve tona, por edhe një thirrje për vazhdimin e aktiviteteve dhe veprimeve të përbashkëta. Vetëm përmes përkushtimit të vazhdueshëm dhe bashkëpunimit mund të arrijmë një nivel të lartë të barazisë gjinore dhe të përforcojmë suksesin tonë si ekip.

Në bazë të punës dhe aktiviteteve të realizuara, është e qartë se barazia gjinore nuk është thjesht një qëllim, por një proces i vazhdueshëm që kërkon përkushtim, reflektim dhe veprime konkrete.

Duke punuar së bashku, jemi të sigurt se mund të ndërtojmë një mjedis pune që jo vetëm kërkon angazhim, por edhe pasuron të drejtat dhe barazinë.

Në vazhdim janë të paraqitura aktivitetet e realizuara për vitin 2024



Prezentimi i raportit të punës dhe planit të punës nga ZBGJ, Komitetit për Barazi Gjinore, Komiteti për komunitete dhe Handikos.

Diskutim i hapur lidhur me punën, të arriturat dhe sfidat përgjatë vitit.

Java e Barazisë Gjinore

Gjatë Javës së Barazisë Gjinore, janë organizuar një sërë aktivitete që promovojnë barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në komunitet.

Takim me gratë pensioniste - Një sesion i dedikuar për të diskutuar çështjet që prekin gratë pensioniste, si shëndeti, mirëqenia dhe kontributi i tyre në shoqëri. Gratë ndanë përvojat dhe dhanë sugjerime për nisma të reja.

Takim me fermeret - Një diskutim i hapur mbi rolin e grave në sektorin e bujqësisë, ku u trajtuan sfidat dhe mundësitë për fuqizimin e tyre. Gjithashtu, u ndanë shembuj frymëzues të grave të suksesshme në këtë fushë.

Prezantimi i buletinit informues - Një takim për të prezantuar buletin informues, i cili përmban aktivitete, statistika dhe përvoja që nxisin ndërgjegjësimin për çështjet gjinore.

Aktivitetet në shkollë - Nxënësit e shkollave kontribuan me ese dhe punime nga arti pamor, duke trajtuar tema që lidhen me barazinë gjinore. Këto krijime pasqyrojnë mendimet dhe kreativitetin e brezit të ri për një shoqëri më të barabartë.






Foto te aktiviteve nga Java për Barazi Gjinore






Takimi i radhës u realizua me grupin e grave dhe u diskutua për familjen dhe rolin e gruas në familje, përveç kësaj diskutimi u ndërlihd edhe me rolin e gruas në fusha tjera, duke përmendur sfidat, sukseset dhe menaxhimin e shumë proceseve si në familje, shkollë, punë, vendimmarrje e shoqëri në përgjithësi.

Ndër të tjera u diskutua edhe për rolin dhe përvojat e tyre personale sa i përket familjes, duke u ndalë secila për përgjegjësitë që kanë në raport me familjet e tyre brenda dhe jashtë familjes, poashtu duke krahasuar punën e tyre me punën e anëtarëve të tjerë të familjes.



Të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore – diskutim në dy shkolla me nxënës dhe mësime të mëdha



Grupi i grave në takimin e radhës diskutoj për kulturën dhe traditat, duke u ndërlidhur me ndryshimet ndër vite, gjeneratat, kulturën dhe traditat, dallimet ndër regjione.

Diskutimet u ndërlidhen që takime të tilla të realizohen edhe me të rinjë dhe të percillen vlerat të cilat ndikojnë në ruajtjen e identitetit dhe krijimin e një shoqërie të drejtë dhe të barabartë.

Takim me temën “Buxheti Gjinor” diskutim me drejtorin dhe zyrtarë nga drejtoria për buxhet e financa.

Diskutimi u ndërlidh me reduktimin e pabarazive gjinore, përmirësimin e politikave publike, transparencën, përgjegjshmërinë, mjetet e ndara për ZBGJ të shfrytëzohen vetëm për çështje gjinore, thirrje publike vetëm për organizata e grave.





Takim me temën: roli i burrave dhe grave dhe ndikimi i tyre në barazi gjinore, u diskutua për ndërgjegjësimin, avokimin, ndryshimin e normave tradicionale, ndikimin në familje, pjesëmarrjen në arsim, fuqizimin politik, përmirësimin e marrëdhënjëve shoqërore dhe angazhimin gjithëpërfshirës.




Takimi i radhës me temën **Socializimi** i cili u konsiderua i rëndësishëm në jetën e secilit individ duke përfshirë mësimin, normat, vlerat dhe traditat e roleve shoqërore që pranohen në një grup ose shoqëri të caktuar. gjithëashtu ndikim në socializimin ka edhe familja ku mësohen vlerat bazë, pastaj shkolla, mediat, rrjetet sociale e kështu me radhë.



Në përurimin e veprës 'Malisheva Poetike', vëllimi i dytë për fëmijë me rastin e 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve



Në vazhdim kemi realizuar takimin me temën ***Edukimi*** ku diskutua për edukimin në mënyrë të përgjithshme, duke konsideruar se përveç që promovon barazinë e drejtësinë ndikon edhe në ndërtimin e shoqërive të qëndrueshme e demokratike. Edukimi fillon në familje dhe zhvillohet më tutje në shoqëri e më gjërë, duke rritur ndërgjegjësimin e komunitetit në përgjithësi.



Në këtë takim diskutuam për temën ***Shëndeti dhe Mirëqenia***, dhe nga të pranishmet u potencua se të dyjat janë koncepte të ndërlidhura njëra me tjetrën duke përfshirë aspektet fizike, mendore dhe sociale të jetës së individëve brenda shoqërisë.

Poashtu u theksua nga të pranishmet se për t'u arritur këto është e rëndësishme të ketë një balancë mes jetës aktive dhe mendjës së shëndoshë. Diskutimet u ndërlidhen edhe me depresionin si shkak i mos menagjimit të stresit dhe shkaktarëve tjerë të cilët vinë deri te depresioni.



Realizuar me kërkesë të Zyrës për Barazi Gjinore QPS, dhe përkrahur nga Komuna e Malishevë, u perurua dhoma mike, një hapësirë e veçantë që shërben për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Kjo dhomë është një vend i sigurt dhe i ngrohtë, i dedikuar për viktimat e dhunës, duke ofruar mbështetje dhe kujdes në momentet më të vështira (pjesëmarrës disa prej aktereve të mekanizmit kordinues kundër dhunës në familje).

Me këtë rast, vizituam edhe pjerrinën e përshtatur nga stacioni policor për përdoruesit e karrocave, e cila tregon kujdesin për të gjitha kategoritë e shoqërisë.



Takimi i radhës me temën bugjetimi me pjesëmarrje



Takimi i radhës u realizua me trajnerët e klubeve të vajzave sportiste, ku u diskutua për përvojat, sfidat dhe sukseset e vajzave në klubet sportive. Gjatë takimit u theksua rëndësia e përfshirjes së vajzave në sport, veçanërisht në futboll, si dhe mbështetja e vazhdueshme që duhet t'u ofrojmë për të krijuar mundësi të barabarta.

Pas diskutimeve, patëm mundësinë të vizitojmë stadiumin e qytetit "Liman Gegaj" ku u njoftuam nga afër për punën dhe angazhimin e klubit dhe pamë nga afër stërvitjet e vajzave futbolliste.



Me grupin e grave në vazhdimësi diskutuam temën për **menaxhimin stresit**, për sfidat e përbashkëta, sesionet informuese, bashkëpunimin me ekspertë të fushës, shkaqet, problemet personale, presioni në punë, shëndeti, financat dhe të gjitha ato që ndikojnë në menagjimin dhe tejkalimin e vështërsive.



Punëtori me vajza dhe djem “**Barazia gjinore dhe shkaqet që shkaktjnë pabarazitë**”

Përmes diskutimeve dhe punimeve, të ndarë në grupe nxënësit paraqitën të drejtat dhe barazinë nga këndvështrimi i tyre, duke adresuar çështjet tek edukimi, arsimimi, punësimi shoqëria, trajtimi i barabart në familje.



Me rastin e muajit të ndërgjegjësimit u mbajt marshi i solidarizimit me gratë që po përballen me kancerin e gjirit. Ky ishte një moment i rëndësishëm për të përkrahur dhe fuqizuar të gjitha gratë që luftojnë me këtë sëmundje.



Poashtu në kuadër të muajit tetor, organizuar nga SHFMU "Ibrahim Mazreku" në bashkëpunim me QKMF "Shpëtim Robaj" dhe Zyrën për Barazi Gjinore në Malishevë, u mbajtë sesioni informues për kancerin e gjirit.

Te pranishmit u njoftuan për statistikën e përhapjes, shenjat e paraqitjes, nevojën për kontolla të hershme si masë parandaluese dhe mënyrat e identifikimit të shenjave të para të paraqitjes së kancerit të gjirit.



Takimi i radhës me grupin e grave u zhvillua në një ambient të hapur, duke shfrytëzuar natyrën si hapësirë për diskutim të lirë dhe frymëzues. Gjatë bisedës, u trajtuan tema të ndryshme që preokupojnë gratë, duke përfshirë sfidat e përditshme, fuqizimin ekonomik, rolin e grave në shoqëri dhe rëndësinë e mbështetjes reciproke. Atmosfera ishte miqësore dhe bashkëpunuese, duke krijuar mundësi për shkëmbim idesh dhe ndarje përvojash.



Takim kordinues për hapjen e fushatës kundër trafikimit me qenje njerëzore



Prezantimi i punës dhe aktivitetëve nga grupi grave të Komunës së Malishevës në bashkëpunim me Rrjetin “Qeliza”

Aktivite nga Fushata – Kundër Trafikimit me Qenje Njerëzore të përfshira të gjitha shkollat me aktivitete dhe ligjërata me mesazhin - MOS HESHT





Fushata kundër trafikimit me qenje njerëzore ka përfshirë ligjerata nëpër shkolla, sesione informuese të drejtuara nga ekspertë të fushës, aktivitete interaktive për nxënës, punëtori, shpërndarje të materialeve edukative dhe takime sensibilizuese me mësuesdhënës.


Me rëndësi të veçant, u theksua rëndësia dhe bashkëpunimi në mes shkollës, familjes dhe institucioneve të sigurisë.



Me rastin e Ditës së Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, u realizua një takim domethënës mes kryetarit të komunës dhe një grup nxënësish nga SHFMU “Ibrahim Mazreku”. Ky aktivitet shërbeu si një platformë për të dëgjuar zërin e fëmijëve dhe për të promovuar të drejtat e tyre. Gjatë takimit, nxënësit paraqitën punime kreative, përfshirë ese, postera dhe projekte të tjera artistike, të cilat pasqyronin perceptimet dhe mendimet e tyre mbi të drejtat e fëmijëve.

Aktivite nga Fushata – 16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës në familje





Në kuadër të fushatës globale "16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore", të gjitha shkollat e komunës sonë u angazhuan në një seri aktivitesh ndërgjegjëse dhe edukative, duke përfshirë nxënës, mësime dhe qytetar. Qëllimi i kësaj fushate ishte promovimi i barazisë gjinore, parandalimi i dhunës dhe fuqizimi i komunitetit shkollor për të adresuar dhe luftuar këtë problem, duke krijuar një dialog të hapur për rëndësinë e eliminimit të dhunës dhe promovimit të një kulture respekti dhe barazie. U organizuan punëtori interaktive me nxënësit, ku ata morën pjesë në diskutime, aktivitete grupore për të trajtuar situata të ndryshme që ndërlidhen me parandalimin e dhunës në familje.



Me rastin e Ditës Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar, organizuam një ceremoni për të nderuar arritjet dhe kontributin e jashtëzakonshëm të grave dhe të arriturat e tyre në fushën e bujqësisë Takimi shërbeu si një shembull për të promovuar barazinë, përfshirjen dhe fuqizimin e grave që përballen me sfida, duke nxjerrë shembuj frymëzues të suksesit dhe ndikimit pozitiv në shoqëri. Një moment i veçantë i ngjarjes ishte nderimi i fermeres e cila ka tejkaluar pengesat e saj dhe ka ndërtuar një histori suksesi të jashtëzakonshëm në sektorin e bujqësisë. Përmes përkushtimit, punës së palodhur ajo ka arritur të transformojë fermën e saj në një model të suksesit, duke ofruar frymëzim për gratë e tjera dhe duke kontribuar në zhvillimin e një shoqërie të barabartë.

Të dhënat statistikore në baza gjinore

Komuna e Malishevës ka gjithësejtë 43.888 banorë me numër të përgjithshëm, 22.572 femra dhe 21.316 meshkuj.

Prej 41 shkollave amë dhe dy paraleleve kemi 7 drejtoresha dhe 1 drejtoreshe e çerdhes)

Janë të regjistruara gjithësejt 138 biznese – 22 femra – 116- meshkuj

Institucioni	Nr i përgjithshëm	Gra	Burra
Komuna Arsimi Shëndetësi	1332	34.98%	65.2%

Asambleja Komitetet	Nr i përgjithshëm	Gra	Burra	Perqindja
A.komunale	31	11	20	35%
KPF	7	4	3	57%
K.Komunitete	5	3	2	60%
K.Diasporë	5	3	2	60%

KBGJ	5	4	1	80%
K.Bujqësi dhe zhvillim rural	5	1	4	20%
K.Arsim Kulturë Rini Sport	5	2	3	40%
K. Shend. Mirëqenje Sociale dhe Persona me Aftësi të Kufizuar	5	//	5	//
K. për Familje të Dëshmorëve Invalid, Veteran të Luftës së UÇK Martir të Luftës	5	//	5	//
K.Planifikimi Urban Kadastër Mbrojtje të Mjedisit,Turizëm, Monitorim të Projekteve	5	1	4	20%

Bashkëpunimi me zyrtarin ligjor nga zyra e avokatit te popullit në nivel regional (çdo muaj me ditën e hapur me qytetarë)

Janë mbajtur 25 ligjerata në QAK (qendra e angazhimit për komunitete)

Kanë përfituar 22 gra nga shoqata Gratë për Gratë, trajnim dhjetë muaj dhe poashtu kanë përfituar mjete pune me vlerë prej 250 dollarëve (bashkëpunimi me shoqatën Fatjona)

Janë subvencionuar 13 fëmijë në çerdhen “Zërat e Embël”

Bashkëpunimi me zyrtarin për ndihmë juridike falas

Bashkëpunimi me Rrjetin “Qeliza”

Zyrtarja për Barazi Gjinore

Vera Bytyçi
